



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.2021

**VENDIM**  
**Nr. 276, datë 01.07.2021**

**MBI**  
**PAKËSIMIN E FONDEVE NË SHPENZIME PERSONELI, NË PROGRAMIN**  
**BUXHETOR “BUXHETI GJYQËSOR” PËR VITIN 2021**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbështetje të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, Udhëzimit nr. 9, datë 20.3.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, të Ministrit të Financave, Udhëzimit plotësues nr. 4, datë 25.01.2021 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2021”, Aktit Normativ nr. 26, datë 22.6. 2021, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021”, si dhe me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik dhe Administrimit të Buxhetit,

**V E N D O S I:**

1. Të miratojë pakësimin e fondeve buxhetore, në shpenzime korrente, artikullin shpenzime personeli (paga dhe sigurime shoqërore), në programin 03310 “Buxheti Gjyqësor”, në vlerën 80,000,000 lekë.
2. Ngarkohet me zbatimin e këtij vendimi Sekretari i Përgjithshëm dhe Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**